



KOMUNA E GRAÇANICËS

PROGRAMI TREVJEÇAR I BANIMIT 2022-2025



Korrik 2022

PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	4
2	QËLLIMI.....	4
3	KORNIZA LIGJORE.....	5
4	DOKUMENTET TJERA RELEVANTE.....	5
5	STRATEGJIA E ZHVILLUAR NË NIVELIN QEVERTAR.....	6
6	PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT.....	6
7	PROFILI I KOMUNËS SË GRAÇANICËS.....	7
	7.1 Themelimi i Komunës së Graçanicës.....	7
	7.2 Pozita gjeografike dhe karakteristikat.....	8
	7.3 Karakteristikat demografike - Popullsia.....	9
	7.4 Migrimi.....	10
	7.5 Shtimi i ekonomive familjare.....	11
	7.6 Struktura e popullsisë sipas moshës.....	11
	7.7 Vendbanimet.....	12
	7.8 Vendbanimet joformale.....	13
8	GJENDJA FAKTIKE.....	13
	8.1 Banimi - Fondi banesor.....	15
	8.2 Të dhënat për objektet e ndërtuara banesore në territorin e komunës së Graçanicës.....	15
9	KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE.....	16
10	ANALIZA E FAKTEVE.....	17
	10.1 Nevojat për përkujdesje për strehimin e përfituesve të Skemës së Ndhmës Sociale.....	17
	10.2 Punësimi.....	19
	10.3 Papunësia.....	19
	10.4 Analiza ekonomike - gjendja.....	20
	10.5 Mjedisi i biznesit.....	20
	10.6 Të ardhurat.....	21
11	KATEGORITË E SYNUARA.....	21
12	PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURA.....	22
13	PËRFUNDIMET.....	22
	13.1 Vizioni.....	23
	13.2 Detyra-Misioni.....	23
	13.3 Qëllimi i përgjithshëm.....	23
14	KLASIFIKIMI I NEVOJAVE SIPAS URGJENCËS SË VEPRIMIT.....	23
15	VEPRIMET KRYESORE QË DO TË NDËRMERREN –.....	23
	15.1 Programet që janë identifikuar si të përshtatshme për nevojat e banimit në komunën e Graçanicës.....	23
16	JUSTIFIKIMI I VEPRIMEVE DHË SHPJEGIMI I REZULTATEVE TË PRITURA.....	25
17	KOHËZGJATJA E REALIZIMIT TË PROGRAMEVE.....	26
18	KORNIZA E SHPENZIMEVE AFATSHKURTËRA, AFATMESME DHE AFATGJATE TË NDARA BRENDA PERIUDHËS TREVJEÇARE.....	26
19	MUNDËSITË DHE KAPACITETET NJERËZORE DHE MATERIALET E KOMUNËS ..	26

20. MËNYRA E FINANCIMIT TË PROGRAMEVE TRE VJEÇARE	27
21. PËRPUTHJA E PROGRAMEVE ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS	27
22. NDËRLIDHJA E PROGRAMEVE ME PROGRAMET E PËRGJITHSHME DHE ORIENTIMET E POLITIKAVE TË QEVERISJES QENDRORE	27
23. INSTRUMENTET E MBIKËQYRJES	27
24. INSTRUMENTET E GARANTIMIT TË REALIZUSHMËRISË SË PROGRAMEVE	27
25. MASAT QË DO TË NDËRMERREN PËR RESPEKTIMIN E KORNIZËS LIGJORE, VEÇANERISHT KORNIZËS FINANCIARE DHE KOHORE PËR ZBATIMIN PROGRAMIT..	28
26. MASAT QË DO TË NDËRMERREN PËR TRANSPARENCËN NË LIDHJE ME HARTIMIN DHE PËRGATITJEN E PROGRAMIT.....	28
27. PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPARENCË.....	28
28. ANALIZA SWOT	29

1. HYRJA

E drejta për banim është njëra ndër të drejtat fundamentale të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe me Kartën evropiane të drejtave të njeriut.

Nga aspekti social, banimi adekuat është një e drejtë themelore e njeriut, ndërsa nga aspekti i palnifikimit hapësinor/urban banimi konsiderohet si shfrytëzues më i madhi i hapësirës. Si çështje sociale dhe çështje e planifikimit strategjik të në vendi, adresimi i çështjes së banimit në mënyrë të duhur siguron zhvillim social dhe ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst çasja në banim është një disiplinë multisektorale mjaft komplekse që kërkon nga autoritetet qendrore dhe komunale përkushtim dhe vullnet politik për të adresuar me kompetencë këtë çështje.

Me miratimin e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit i është dhënë një kornizë më e avancuar autoriteteve vendimarrësve lokale për të ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Kosovës.

Sigurimi i banimit është bazë për funksionalizimin e familjes, shoqërisë por edhe vet shtetit, si për nga stabiliteti psikosocial ashtu edhe ekonomik. Andaj, me këtë program pretendojmë që të vendosim rend në adresimin e çështjeve të banimit në komunë për të ofruar banim me qera joprofitabile për kategoritë e popullatës që nuk kanë fuqi ekonomike për të paguar qera në tregun e lire të banesave.

2. QËLLIMI

Qëllimi i hartimit të Programeve trevjeçare të banimit është adresimi i çështjeve të banimit në komunën e Graçanicës, duke u bazuar në politikat qendrore të banimit dhe të dhënat statistikore të analizuar më parë, që paraqesin gjendjen reale të banimit dhe nevojat e ardhshme në bazë të analizës së tendencave, rritjes së popullsisë, si dhe rritjes ekonomike etj. Pas kësaj, është mundësuar adresimi i tyre i drejtë, duke i klasifikuar sipas urgjencës së veprimit, aktiviteteve kryesore që duhet të zbatohen, kohës së zgjatjes për zbatimin e programit, kornizës afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shpenzimeve të ndara brenda periudhës trevjeçare, mundësisë së kapaciteteve njerëzore dhe materiale të komunës, mundësisë së financimit të programit trevjeçar, harmonizimit të programit me planet zhvillimore të komunës, ndërlidhjes së programit me programet e përgjithshme dhe levizjet e politikave të pushtetit qendror, instrumenteve të mbikëqyrjes, instrumenteve për garantimin dhe realizimin e programit, duke marrë parasysh:

- Identifikimin e pasqyrës reale të problemeve në komunën e Graçanicës që kanë të bëjnë me çështjen e banimit.
- Zhvillimin e politikave adekuate që përfshijnë specifikat lokale, veçoritë gjeografike, demografike dhe institucionale për zbatimin e tyre me qëllim që të mundësohet zgjidha e

nevojave për banim për grupe të caktuara, të cilat nuk kanë forcë ekonomike për të siguruar banim me çmime të tregut.

- Krijimin e kushteve për banim të përshtatshme dhe të qëndrueshme në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit.
- Gjetjen e mënyrave të financimit për realizimin e zbatimit të Programit trevjeçar të banimit.

Dokumenti është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit, duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit dhe njëkohësisht i nënshtrohet zbatimit të metodës së planifikimit strategjik që nënkupton dhënjen e përgjigjes në pyetjet:

- Ku jemi? që i referohet analizës së gjendjes ekzistuese
- Ku do të shkojmë? Synimet,
- Si të arrijmë atje? objektivat, veprimet, projektet etj.
- Si të bindemi se kemi mbërri? monitorimi dhe vlerësimi.

Dokumenti është hartuar nga grupi punues komunal dhe tenton të përshkruajë një rrjedhë logjike të banimit që nga themelimi i qytetit, gjendjes ekzistuese dhe projeksioneve të zhvillimit të banimit në vitet në vijim.

3. KORNIZA LIGJORE

- Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit,
- Udhëzimi administrativ - për përmbajtjen e kontratës për banesën me qera joprofitabile,
- Udhëzimi administrativ - për përmbajtjen e bonusit të banimit,
- Udhëzimi administrativ – për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit,
- Udhëzimi administrativ - për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit,
- Udhëzimi administrativ – për parimet minimale të banimit nga programet e veçanta të banimit,
- Udhëzimi administrativ - për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit,
- Ligji nr. 04/L-134 për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi,
- Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale,
- Ligji nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
- Ligji nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247
- Ligji nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.


4. DOKUMENTET TJERA RELEVANTE

- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit
- Statuti i komunës
- Plani zhvillimor i komunës së Graçanicës

5. STRATEGJIA E ZHVILLUAR NË NIVEL QEVERTAR

- Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2017 - 2021 dhe Plani i veprimit mbi zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për integrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve 2017-2021.
- Rregullorja (QRK) nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të përhershme
- Rregullorja (QRK) nr. 08/2015 për integrimin e personave të kthyer dhe për menaxhimin e programit të riintegritimit
- Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2018/2022
- Plani komunal i veprimit për personat e zhvendosur dhe zgjidhja e qëndrueshme 2022/2025¹

6. PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMIT



Diagrami hierarkik në procesin e hartimit të PTB

¹ Zyre për Komunitete dhe Kthim, Komuna e Graçanicës

- Vendim për formimin e Komisionit për përgatitjen e Programit trevjeçar të banimit për banim social të Komunës së Graçanicës nr. 1990/22 nga 20.04.2022;
- Përcaktimi i përshkrimit të punëve dhe detyrave të Komisionit;
- Departamenti për përkrahje – mbledhje të informatave mbi çështjet e banimit nga sektorët përkatëse në Komunë dhe institucionet tjera relevante;
- Dokumentet komunale;
- Struktura e buxhetit komunal;
- Identifikimi i kategorive të synuara;
- Prezantimi publik - njoftim;
- Përgatitja e dokumentacionit;
- Procedura për dhënien e pëlqimit e dokumentacionit;
- Shqyrtimi publik;
- Aprovimi nga Kuvendi Komunal (procedura e miratimit të programit);
- Realizimi dhe mbikëqyrja e PTB.

Komisioni për hartimin e programit

Nr.	Emri dhe mbiemri	Drejtoria	Përgjegjësia në komision
01.	Mirjana Stanojević	Drejtor i Drejtorisë së urbanizmit, planifikimit, dhe mbrojtjes së mjedisit	Kryesuese
02.	Snežana Krstić	Zyrtare për banim	anëtare
03.	Marina Mitić	Arkitekte pran Drejtorisë së urbanizmit, planifikimit, dhe mbrojtjes së mjedisit	anëtare
04.	Sonja Nešić	Zyrtare për mirëqenie sociale	anëtare
05.	Dragan Stanojević	Zyrtar për zhvillim ekonomik	anëtar

7.PROFILI I KOMUNËS SË GRAÇANICËS

7.1. Formimi i komunës së Graçanicës

Komuna është themeluar në pajtim me planin e Ahtisaarit nëpërmjet përfshirjes së pjesëve të komunave të: Prishtinës, Lipjanit dhe Fushë Kosovës. Komuna e Graçanicës përfshin vendbanimet dhe njësitë kadastrale si në vijim:

- nga komuna e Fushë Kosovës: Batushë dhe Uglar;
- nga komuna e Lipjanit: Gushterica e Epërme, Dobratin, Gushterica e Poshtme, Lepina, Livagjë, Radeva, Skullanev dhe Suhadoll,
- nga komuna e Prishtinës: Graçanica, Badoci i Ri, një pjesë nga Badoci i Vjetër, Llapnasellë, Sushica, Preoc, Kishnica dhe një pjesë e Çagllavicës.

Komuna e Graçanicës është themeluar në pajtim me Ligjin për kufijtë administrativë të komunave të miratuar më 20 shkurt 2008. Pasuar nga zgjedhjet e 15 nëntorit të vitit 2009, Komuna e Graçanicës është themeluar zyrtarisht më 29 dhjetor 2009.

Komuna e Graçanicës është e vendosur në pjesën qendrore të Kosovës. Komuna është e ndarë në 16 zona kadastrale. Komuna ka një karakter rural me tokë bujqësore të kualitetit të lartë.

Në figurën 1 është paraqitur pozita e Kosovës dhe komunës së Graçanicës



Figura 1

7.2 Pozita gjeografike dhe karakteristikat

Komuna e Graçanicës është e vendosur në pjesën qendrore të Kosovës, me kufijtë e saj në veri dhe lindje me komunën e Prishtinës, në jug me komunën e Lipjanit dhe po ashtu në jug me komunën e Fushë Kosovës.



Qendra administrative e komunës është vendbanimi Gračanica, që ndodhet tetë kilometra në jug-lindje nga Prishtina, në skajin lindor të basenit të Kosovës, ku fillon ngritja e lehtë e shpateve Veletin, me lartësi mbidetare prej 874 m dhe shpatet e rrëpira të Strazevcit me lartësi mbidetare prej 796 m, si edhe Glasnoviku. Vendbanimi është i vendosur në afërsi të lumit Graçanka, furnizues i lumit Sitnica, në kuadër të luginës së madhe poshtë liqenit të Graçanicës dhe deponisë së mbeturinave industriale të Kishnicë-Novobërdës, objekteve të minierave të plumbit dhe zinkut. Fshati ka një lartësi mbidetare prej 570m dhe është i vendosur në pjesën e basenit tektonik, si dhe shtrihet përgjatë çarjes që nga mesi-terciar. Veletini dhe Maja e Mprehtë janë maja të shuara vullkanike të pasura me gurë mineral.

Rruga rajonale që kalon përmes vendbanimit lidh Graçanicën me Serbinë jug-lindore dhe rrugët që shpijnë drejt Anamoravës perëndimore që lidhin Graçanicën me Detin Adriatik dhe Shqipërinë.

Lumi Graçanka i takon sistemit të lumit Sitnicë. Pranë fshatit gjendet liqeni artificial i Graçanicës. Diga në lum u ndërtua në periudhën 1963-1966. Ky liqen siguron ujë të pijshëm për një numër të vendbanimeve në Kosovën qendrore, duke përfshirë Prishtinën, Graçanicën dhe vendbanimet përreth.

7.3. Karakteristikat demografike -Popullsia

Plani trevjeçar i banimit

Bazuar në të dhënat të Komunës së Graçanicës, në vitin 2022 në komunë jetojnë 27,000 banorë. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare në Kosovë të vitit 2011 nuk mund të merren si autentike meqë regjistrimi u realizua vetëm pjesërisht (është vlerësuar se rreth 50% e popullsisë është përfshirë në regjistrim-burimi: Komisioni komunal i regjistrimit). Plani është kryerja e një regjistrimi të ri të popullsisë, i cili do të përcaktojë gjendjen reale numerike të popullsisë.

Brenda territorit të komunës së Graçanicës gjenden rreth 5.400 ekonomi familjare.²

Tabela 1. Popullsia

POPULLSIA		
1	Dendësia e banimit	220,71 ban/km ²
2	Mosha (kryesisht % e moshës së re)	17.2% 20-29 vjeç
3	Familja mesatare	5 anëtarë
4	Nataliteti	0.94 %
5	Arsimimi	Numri i përgjithshëm i nxënësve është 3981 Numri i përgjithshëm i personelit është 222 (sistemi i Kosovës)
6	Migrimi	Sipas vlerësimeve të UNHCR ³ -së, nga viti 2001 deri në korrik 2021, në komunën e Graçanicës janë kthyer gjithsej 530 familje me 1855 anëtarë, përkatësisht: • Serbët: 456 familje me 1508 anëtarë • Romë: 60 familje me 273 anëtarë • Ashkali: 12 familje me 64 anëtarë • Malazez: 1 familje me 5 anëtarë
7	Ekonomitë familjare	5400
8	Banesat	/
9	Situata ekonomike	586 ndërmarrje

² Këshilli Lokal

³ Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

- Sipas regjistrimit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, në të cilin morën pjesë rreth 50% të popullatës së komunës, popullata e re e moshës 20-29 paraqet një proporcion të lartë prej 17.2%.⁴
- Sipas të dhënave të ofruara nga Drejtoria e shëndetësisë, p.sh KGjO⁵, në mesatare, rritja vjetore e popullsisë ishte 236 banorë, çka në proporcion me numrin e vlerësuar prej 25.000 banorësh jep rritje vjetore natyrale prej 0.94%.
- Komuna e Graçanicës mbulon njëzet (20) institucione arsimore dhe edukative në territorin e saj, ku nga të cilat (3) janë kopshtet për fëmijët me objektet në 12 vendbanime, (7) janë shkolla fillore me objektet në 16 vendbanime dhe (8) janë shkolla të mesme të cilat mësojnë në ambientet e shkollave fillore, me përjashtim të 3 shkollave të cilat prej kohësh janë të vendosura në Qendrën e shkollës së mesme.
 - Ukupan broj učenika 3981
 - Ukupan broj radnika 222 (sistemi i Kosovës)

Tabela 3. Shfrytëzimi i tokës

NR	Njësia	Ha	Km2	%
1	Tokë bujqësore e punueshme (ara)	8.772,61	87,7261	71,76
2	Vreshtat	35,33	0,3533	0,29
3	Livadhe	646,98	6,4698	5,29
4	Kullotat	906,56	9,0656	7,42
5	Tokë pyjore	588,37	5,8837	4,81
6	Sterilet	48,35	0,4835	0,40
7	Pellg	69,82	0,6982	0,57
8	Liqeni	41,44	0,4144	0,34
9	Pjesa urbane me infrastrukturë	1.115,54	11,154	9,12
	TOTAL	12.225,00	122,25	100

7.4. Migrimi

Lëvizshmëria e popullsisë është karakteristikë e shoqërisë njerëzore që nga fillimi i saj e deri në kohën e tanishme. Gjithashtu, në këtë zonë ekzistojnë të ashtuquajturat migrimet të detyruara, të cilat janë si rezultat i trazirave të mëdha sociale- politike e mbi të gjitha si rezultat i konflikteve të luftës. Zyra e UNHCR-it në Prishtinë nuk ka asnjë informacion zyrtar lidhur me numrin e personave të zhvendosur nga territori i komunës së Graçanicës.

Sipas vlerësimeve të UNHCR-it nga viti 2001, deri në korrik të vitit 2021, 530 familje me 1,855 anëtarë të familjes u kthyen në komunën e Graçanicës, me përbërjen e mëposhtme:

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës

⁵ Klinika Gjinekologjike dhe Obstetrike, Komuna e Graçanicës

- Serb: 456 familje me 1,0508 anëtarë të familjes;
- Romë: 60 familje me 273 anëtarë të familjes;
- Ashkali: 12 familje me 64 anëtarë të familjes;
- Malazezë: 1 familja me 5 anëtarë të familjes.

Njëkohësisht, ekziston migrimi dhe proceset e migracionit në këtë zonë. Gjegjësisht, ka njerëz që nuk duan të largohen nga kjo zonë, por më parë do të kërkojnë një jete më të mirë në Graçanicë dhe në mënyrë që ata zhvendosen nga vendbanimi i tyre në Graçanicë, si një qendër kryesore administrative, arsimore, shëndetësore dhe kulturore, jo vetëm serbe, por edhe të etnive tjera.

Nuk ka asnjë informacion të saktë mbi numrin e atyre që janë larguar jashtë vendit. Shumë emigrantë në kërkim të një jete më të mirë u larguan drejt vendeve skandinave, si dhe në drejtim të Evropës perëndimore.

Numri i përgjithshëm i familjeve të riatdhësura të regjistruara në Zyrën komunale për komunitete dhe kthim që nga themelimi i komunës së Graçanicës është 109, i përbërë nga:

- 231 Burra;
- 24 Gra;
- 54 Fëmijë.

Zyra komunale për kthim dhe komunitete (ZKKK) që nga themelimi i saj, nga muaji maj deri në muajin nëntor 2012 i regjistroi 70 persona të riatdhësuar. Nga ky numër, 48 persona i përkasin komunitetit RAE (romë, ashkalinjë dhe egjiptas) dhe 22 të komunitetit serb. Para fillimit të punës së saj, ZKKK-ja e Graçanicës regjistroi 34 persona të riatdhësuar, të gjithë nga komuniteti RAE. Ky regjistër përfshin edhe personat e sjellë në Aeroportin e Prishtinës.⁶

7.5. Shtimi i popullsisë

Sipas të dhënave të Zyrës së Regjistrimit të Komunës së Graçanicës, për periudhën prej 01.01.2018. deri me 31.12.2018, në komunën e Graçanicës janë regjistruar 410 lindje dhe 243 vdekje, ndërsa shtimi natyror absolut i popullsisë për periudhën e përmendur është vlerësuar të jetë 15,6%⁷. Për periudhën prej 01.01.2019. deri më 31.12.2019. janë regjistruar 371 lindje dhe 224 vdekje, shtimi natyror absolut për periudhën e përmendur është vlerësuar në 13.7%. Për periudhën prej 01.01.2020. deri më 31.12.2020. janë regjistruar 358 lindje dhe 237 vdekje, ndërsa shtimi natyror absolut është vlerësuar në 11.3%. Për periudhën prej 01.01.2021. deri më 30.06.2021. janë regjistruar 173 lindje dhe 166 vdekje⁸. Sipas këtyre të dhënave, mund të konstatojmë se numri i banorëve për vitin 2019 është ulur për 39 krahasuar me vitin 2018. Në vitin 2020, popullsia gjithashtu u ul për 13.

7.6. Përbërja e popullsisë sipas moshës

⁶ Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

⁷ Plani zhvillimor institucional për kujdesin parësor shëndetësor Komuna e Graçanicës 2020-2024, nr. 8426/19 dt. 27.11.2019

⁸ Departamenti i Shëndetësisë, Komuna e Graçanicës

Sipas regjistrimit të popullsisë së Kosovës të vitit 2011, në të cilin morën pjesë rreth 50% të popullatës së komunës, popullata e re e moshës 20-29 paraqet një proporcion të lartë prej 17.2% nga popullsia totale e regjistruar në komunën e Graçanicës⁹.

7.7. Vendbanimet

Komuna e Graçanicës është një komunë rurale e përbërë nga 16 zona kadastrale, ku kryesisht është përfshirë banimi individual dhe një përqindje shumë e vogël e banimit kolektiv. Sipas rezultateve preliminare të Institutit për statistikë nga viti 2011, në komunë ka 3250 njësi individuale për banim, ndërsa sipas të të dhënave të përfaqësuesve të fshatrave nga viti 2022 ekzistojnë 5400 njësi individuale.

Komuna e Graçanicës përfshin vendbanimet dhe njësitë kadastrale si në vijim:

- nga komuna e Fushë Kosovës: Batushë dhe Uglar;
- nga komuna e Lipjanit: Gushterica e Epërme, Dobratini, Gushterica e Poshtme, Lepina, Livagjë, Radeva, Skullanev dhe Suhadoll,
- nga komuna e Prishtinës: Graçanica, Badoci i Ri, një pjesë nga Badoci i Vjetër, Llapnasella, Sushica, Preoci, Kishnica dhe një pjesë e Çagllavicës.

Tabela 4. Shfrytëzimi i tokës

SHFRYTËZIMI I TOKËS		
1	Sipërfaqja e tokës ndërtimore	1828,6 ha
2	Sipërfaqja e planifikuar - tokë bujqësore	9732,0 ha
3	Sipërfaqja totale e banimit	737.36 ha
4	Sipërfaqja e banimit të planifikuar	6,98 ha
5	Individual	734.68 ha
6	Kolektiv	2,68 ha

Tabela 5. Mbulueshmëria me plane

MBULUESHMËRIA ME PLANE		
1	Sipërfaqja e përgjithshme e komunës e përfshurë në PZHK	122,25 km ² .
2	Sipërfaqja e përgjithshme e komunës e përfshirë me dokumentacionin e planifikimit urban nga viti 1987.	482 ha (4,82 km ²)
3	Mbulueshmëria me Plane rregulluese	/
4	Nr. i vendbanimeve joformale në Komunë	0

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës

7.8 Vendbanimet joformale

Termi “Vendbanim joformal” është përdorur për herë të parë në Planin për zbatimin e standardeve në Kosovë në vitin 2004, në të cilin është konstatuar se nën përkufizimin “vendbanime joformale janë vendbanimet njerëzore që nuk u ofrojnë banorëve të tyre mundësinë të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm jetese, veçanërisht për strehimin adekuat”.

Me nënshkrimin e Deklaratës së Vjenës në vitin 2005, anëtarët ranë dakord për masat që do të rregullonin vendbanimet joformale në mënyrë të qëndrueshme, gjë që do të parandalonte krijimin e tyre në të ardhmen. Deklarata u pasua nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian në vitin 2006, i cili vendos një detyrim për të rregulluar vendbanimet joformale.

Në bazë të Ligjit 04/L-147 për planifikimin hapësinor, “Vendbanimi joformal” karakterizohet si vendbanim që:

- ndërtuar në tokë pa të drejtë pronësie,
- ka akses të pamjaftueshëm në shërbimet bazë ose mungesë të shërbimeve bazë
- pjesëmarrja e pamjaftueshme ose mospjesëmarrja në menaxhim
- banorët janë subjekt i një shkalle të lartë diskriminimi

Komuna e Graçanicës është përballur me shumë probleme që nga dita e parë e formimit të saj. Një nga problemet është se e gjithë komuna është rurale dhe duhet rregulluar. Bazuar në kriteret e dhëna për vendbanimet joformale, në bazë të Planit Zhvillimor të miratuar më parë të Komunës së Graçanicës, është bërë një analizë e detajuar e të gjitha vendbanimeve dhe është konstatuar se në komunë ka 15 vendbanime joformale. Shtatë vjet pas miratimit të PZHK-së, ka pasur përparim të konsiderueshëm në zhvillimin e këtyre vendbanimeve, si në aspektin të infrastructures sociale ashtu edhe në atë fizike.

Në bazë të analizave të reja të bëra, dhe duke marrë parasysh projektet e realizuara, është konstatuar se disa vendbanime që kanë qenë joformale në vitin 2010 tani kanë marrë statusin e vendbanimeve formale. Që atëherë janë regjistruar 15 vendbanime joformale, ndërsa sot **nuk ka vendbanime joformale** në territorin e komunës së Graçanicës.

8. GJENDJA FAKTIKE

Tabela 6. Gjendja faktike (të dhënat e marra nga terreni dhe nga draft-Plani zhvillimor komunal i Graçanicës)

TEMA: Gjendja aktuale, kërkesat dhe analiza	Përshkrimi
KOMUNA	Graçanicë
Nr. i popullsisë	27,000.00

Zonat rurale		16	
Zonat urbane		—	
Sipërfaqja e banuar		18,286 km ²	
Banimi individual	Nr. objekteve para 1999	3 252	
	Nr. objekteve pas 1999	5 400	
	Etazhiteti mesatar	P+1	
Banimi kolektiv	Para 1999	Nr. objekteve	2
		Njësia e banimit	25
	Pas 1999	Nr. objekteve	32+3 në ndërtim
		Njësia e banimit	340+52 në ndërtim
	Etazhiteti mesatar		P+3
Statusi pronësor	Privat (nj.banimi)	/	
	Shoqëror (nj.banimi)	340+52 në ndërtim	
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]		70%	
Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]		100%	
Nr. i objekteve të pabanuara		/	
Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim		2	
Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]		100%	
Ndërtimet ilegale	Mbindërtimet	/	
	Ndërtimet tjera	/	
	Ndërtimet në pronë shoqërore		
Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit		1507 (gjithsej 742 aplikime nga viti 2016 për materiale ndërtimi, 633 kërkesa për banim, 126 kërkesa për ndërtim të objekteve të reja banesore dhe 6 aplikime për subvencionimin e qirasë, nga të cilat 228 aplikime janë anuluar në konkursin e fundit, d.m.th. 1507-228 – 1279 aplikacionet)	

Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit		14,18 ha (Suhadoll, Skullanev dhe Llapnasellë)
Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe Donatorët		35/392
Nr. i objekteve/nj. banimi me qira nga dhe vlera mes. e qerasë		/
Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut		/
Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që mund të adaptohen		/
Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)	Numri i QPK	1
	Vendndodhja /emërtimi	Uglar/Bergen
	Nr. i familjeve	21
	Nr. i banorëve	23
Planet rregulluese - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen		Draft-Plani zhvillimor komunal është në procedurën e hartimit

8.1. Banimi –Fondi banesor

Tabela 7. Fondi banesor

FONDI BANESOR		
1	Nr. i objekteve të banimit	32+3 objekte kolektive në ndërtim 5400 objekte individuale
2	Nr. objekteve/ banesave në pronësi të komunës së Graçanicës	33 ndërtesa (358 banesa, ku nga to 268 janë të shpërndara, 38 banesa të pashpërndara, 52 banesa në ndërtim)
3	Nr. objekteve/ banesave në pronësi të komunës së Prishtinës me seli në Graçanicë	1 ndërtesë (20 banesa)
4	Nr. objekteve/ banesave në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore të Republikës së Serbisë	1 ndërtesë (14 banesa të shpërndara)
5	Qendra për banim social nën kompetencat e komunës së Graçanicës	1 (vendbanimi Bergen - 6 objekte individuale për banim me etazhitet P+1, me 22 njësi të përgjithshme për banim)

6	Qendrat të perkohshme kolektive - QPK	Uglar/Bergen
---	---------------------------------------	--------------

8.2. Të dhënat për objektet e ndërtuara banesore në territorin e komunës së Graçanicës

Sipas informatave që ne kemi:

- Në vitin 2007 filloi ndërtimi i 70 njësive banesore në formë të shtëpive dyshe me etazhin përdhëz në lokacionin Badovci i Ri, të financuara nga institucioni i Republikës së Serbisë në një shumë prej 1.124.387,61€. Në të njëjtin vit ka filluar edhe ndërtimi i objektit kolektiv banesor me etazhitet Po+P+4 në lokacionin Padallishtë në Graçanicë, të financuar nga institucioni i Republikës së Serbisë në një shumë prej 419.418,73€.
- Në vitin 2008 është ndërtuar një shtëpi në lagjen e romëve në Graçanicë për komunitetin RAE, e financuar nga UNDP-i.
- Në vitin 2009 është ndërtuar objekti kolektiv banesor për banimin social në Graçanicë me etazhitet Po+P+4, i financuar nga Ministria për punë dhe mirëqenie sociale në një shumë prej 588.207.10€.

Ministria për komunitete dhe kthim ndërtoi 3 objekte banesore me 60 njësi banesore në Llapnasellë. Ajo ndërtoi edhe 1 shtëpi për familjen e kthyer nga UNDP – ja përmes programit SPARK .

- Në vitin 2010 është ndërtuar objekti kolektiv banesor për banimin social në Dobratin me etazhitet P+2, i financuar nga Ministria për punë dhe mirëqenie sociale të Republikës së Kosovës në një shumë prej 281.994.02€.

Ministria për komunitete dhe kthim dhe UNHCR -i, në kuadër të MoU2 kanë ndërtuar 4 shtëpi.

Ministria për komunitete dhe kthim ka ndërtuar 2 ndërtesa banesore me 48 njësi banesore në Llapnasellë.

- Në vitin 2011 është ndërtuar objekti kolektiv banesor për banimin social në Dobratin me etazhitet P+2, i financuar nga Ministria për punë dhe mirëqenie sociale të Republikës së Kosovës në një shumë prej 372.209.43€. Ky objekt është financuar nga Zyra për çështje të komuniteteve pranë Kabinetit të kryeministrit, Ministria për komunitete dhe kthim dhe Ministria për punë dhe mirëqenie sociale. Pjesëmarrja e MPMS - së në këtë investim ishte 48.368.00€. Janë ndërtuar gjashtë (6) shtëpi nga Ministria për komunitete dhe kthim (MZP) në kuadër të programit Mou4 për 6 familje serbe me 29 anëtarë (3 në Graçanicë, 2 në Gushtericën e Poshtme dhe 1 në Dobratin). Ministria për komunitete dhe kthim ka ndërtuar 2 objekte banesore me 40 njësi banesore në Graçanicë.
- Në vitin 2012 janë ndërtuar dy (2) shtëpi për 2 familje serbe me 8 anëtarë (1 shtëpi në Sushicë dhe 1 shtëpi në Dobratin) - MKK.
- Në vitin 2013 Ministria për komunitete dhe kthim ka ndërtuar 2 objekte banesore me 40 njësi banesore në Graçanicë.

- Në vitin 2016 Komuna e Graçanicës në bazë të hartës sociale të banesave ka ndërtuar 2 objekte banesore në Suhadoll prej 4 njësi banesore, gjithsej 8 njësi banesore në vlerë prej 154,938,33€, të financuara nga buxheti komunal, përmes grante qeveritare.
- Në vitin 2017 Komuna e Graçanicës në bazë të hartës sociale të banesave ka ndërtuar 2 objekte banesore në Suhadoll nga 4 njësi banesore, gjithsej 8 njësi banesore në vlerë prej 132,437,66€, të financuara nga buxheti komunal përmes granteve qeveritare.
- Në vitin 2018 Komuna e Graçanicës në bazë të hartës sociale të banesave ka ndërtuar 2 objekte banesore – shtëpi në Sushicë në vlerë prej 22,848,79€ dhe në Graçanicë në vlerë prej 12,991,79€, të financuara nga buxheti i komunës nga të hyrat vetanake, si dhe ndërtimi i një shtëpie në Gushtericën e Epërme në vlerë prej 18,621,50 € e financuar nga buxheti komunal përmes të hyrave vetanake. Komuna e Graçanicës ka ndërtuar 4 objekte banesore nga 16 njësi banesore në Llapnasellë, faza I, në vlerë prej 255,519,41€, të financuara nga buxheti komunal me të hyrat vetanake. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale ka ndërtuar 2 objekte banesore nga 8 njësi banesore në Llapnasellë, faza II, në vlerë prej 140,080,66€.
- Në vitin 2019, Komuna e Graçanicës ka ndërtuar 3 objekte banesore nga 12 njësi banesore në Gushtericën e Ulët në vlerë prej 248,573,33€, bazuar në hartën sociale të banesave, të financuara nga buxheti komunal përmes granteve qeveritare dhe të hyrave vetanake. Në bazë të hartës sociale të banesave, komuna e Graçanicës ka ndërtuar 6 objekte banesore - shtëpi në Dobrotin, Graçanicë, Livaxhe, Llapnasellë, Lepin dhe Sushicë në vlerë prej 114,179,75€, të financuara nga buxheti komunal përmes granteve qeveritare dhe të hyrave vetanake. .
- Në vitin 2020, Komuna e Graçanicës ka ndërtuar 1 objekt banesor prej 36 njësi banesore për banim social në Graçanicë në vlerë prej 487,331,01€ + 46,779,89€ punë shtesë, të financuara nga buxheti komunal përmes granteve qeveritare, të hyrave vetanake dhe nga MILS.
- Në vitin 2021 Komuna e Graçanicës ka ndërtuar 2 objekte banesore – ndërtim gri, nga 4 njësi banesore, gjithsej 8 njësi banesore për banim social në Llapnasellë në vlerë prej 59,238,01€, të financuara nga buxheti komunal me të hyrat vetanake. Ministria për Komunitete dhe Kthim, Bashkimi Evropian dhe Këshilli Danez për Refugjatët financuan rinovimin e 6 shtëpive ekzistuese - 22 njësi rezidenciale në vendbanimin Bergen në Uglar.

9. KËRKESAT FAKTIKE PËR PËRKRAHJE

Tabela 8. Kërkesat faktike për përkrahje

Kërkesat faktike për përkrahje		
1	Me asistencë sociale nevoja	206
2	Kategoritë e dala nga lufta	/
3	Të kthyerit	330

4	Të riatdhesuarit	4
5	Të moshuarit	/
6	Të rinjtë	/
7	Të punësuarit nga buxheti shtetëror	/
8	Minoritetet	/
9	Tregu i banimit	/
10	Shitja e banesave në treg	/
11	Të dhëna me qera	/
12	Me qera në kushte të caktuara	/
13	Pa qera	/

10. ANALIZA E FAKTEVE

10.1. Nevojat për përkujdesje për strehimin e përfituesve të Skemës së Ndhmës Sociale

Përfituesi i të drejtave ose shërbimeve të Skemës së Ndhmës Sociale është një individ, pra një familje që përballet me pengesa në përmbushjen e nevojave të tyre, si rezultat i të cilave nuk mund të arrijë ose të ruajë cilësinë e jetës, ose që nuk ka fonde të mjaftueshme për të plotësojnë nevojat themelore të jetës dhe nuk mund t'i realizojnë ato me punën e tyre, të ardhurat nga pasuria ose nga burime të tjera. Përfituesit e Skemës së Ndhmës Sociale ndahen në dy kategori:

